

**AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"IMPERIAL DENTAL LABOR" shpk**

Ne Tirane, sot me datë 03.10.2022, me cilesine e "ortakeve themelues" : Z.Brisild Enver Repaj i datelidjes 25/03/1999, identifikuar me leternjoftim me nr.personal J90325027P dhe Z.Glidion Enver Repaj i datelindjes 25/11/1996 , identifikuar me leternjoftim me nr.personal J61125041U madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, mbeshtetur ne : Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare " te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, kemi vendosur krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "IMPERIAL DENTAL LABOR" shpk, (me poshte e quajtur "Shoqeria")

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqeria "IMPERIAL DENTAL LABOR" shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "IMPERIAL DENTAL LABOR" shpk , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "ortaket, te cilet nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gëzojnë kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline kryesore, ne adresen: Rruga "Elbasanit", ndertesa nr.21 shkalla nr.1, ap 12 njesia nr.2, Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Sherbim laborator dentar: Protetike fikse dhe protetike e levizshme.

Glidion Repaj

Neni 5

Brisild Repaj
BR

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise është 100 000 leke, i ndarë në 2 kuota.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar tërësisht nga ortakët e shoqerise perkatesisht:

Z. Brisild Repaj, zoterues i 1 kuote, qe perfaqesojne 50% te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlere te pergjithshme 50 000 leke.

Z. Glidion Repaj, zoterues i 1 kuote, qe perfaqesojne 50% te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlere te pergjithshme 50 000 leke.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat, që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakeve me te njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.



Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare e Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;



ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

KREU II ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9 Organi Vendimmarres

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) ndryshimet e statutit;

c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.


Neni 10 Administrimi

Administratori i shoqërisë është Z. Glidion Repaj.

Administratori i shoqërisë do të ushtroje kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejte ripërteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë. Administratori i shoqërisë mund të emerohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 11



Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- dh) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Administratori në respekt të dispozitave ligjore, mund të kryejë të gjitha operacionet që do të jnë të konsideruara nga administratori të nevojshme dhe të dobishme për të arritur objektivat sociale aty përfaqësohet dhe garancive reale dhe personale dhe besimeve edhe ndaj personave të tretë.
- f) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblesën e përgjithshme edhe në rastet kur :

Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 14 Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15 Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "IMPERIAL DENTAL LABOR" shpk, u redaktua nga une "ortaket themelues" ne 4 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

ORTAKET E SHOQERISE

"IMPERIAL DENTAL LABOR" shpk

Z. Brisild Repaj

Z.Glidion Repaj

